

BIBLIOTEKA

E

814-1

2 50

SHTETIT

GJIROKASTËR

Spiro
Dede

*Njerëzit
për
të cilët
rroj*

POEZI

SH-1
832

265

SPIRO DEDE



Njerëzit
për
të cilët
rroj
poezi

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

NJERËZIT PËR TË CILËT RROJ

Jam i gjithi me ju,
me një lidhje shumë më të fortë se lidhja e gjakut,
jam djali juaj,
jam vëlla,
vetëm me ju kanë kuptim
mëngjeset dhe mbrëmjet.

E nëse për dikë kjo lidhje e ul figurën e njeriut të
kulturës,
do të bëhem si ju një bojaxhi i mrekullueshëm,
një bojaxhi i prapë do të bëhem,
s'do të pranoj të lyej asnjë shtëpi
të atij që i vjen ndot prej jush e prej meje,
as me bojë të zezë shtëpinë s'do të pranoj t'ia lyej...

Do të bëhem si ju një murator i rallë,
një murator i rreptë do të bëhem,

s'do të pranoj të ndërtoj asnjë apartament
për këdo që rri larg meje dhe jush,
as emrin mbi gurin e varrit s'do të pranoj atyre t'ua
gdhend.

Do të bëhem si ju një bujk i mirë,
një bujk kryeneç do të bëhem,
asnjë dorë dhé për saksitë e luleve s'do t'i jap
atij që u rrit për të ndenjtur larg meje dhe jush,
asnjë kalli gruri për të s'do të lëshoj nga dora.

Jam djali juaj,
jam vëlla,
me një lidhje mijëra herë më të fuqishme
se lidhja e gjakut...

KRENARI

Në çdo sekondë të jetës sonë
që kurse lindëm
e sa të jemi,
ti - ylli që na ndriçon rrugën,
ti
gjaku që na rrjedh në deje.

Kur erdhe ti nuk na premtove
as lumë qumështi,
as fushë me lule,
por dashuri si jotja s'kanë
as një mijë shekuj me pekule.

Na dhe stuhinë,
na dhe betejën
«Ja rruga, — the, — asgjë s'vjen vetë!»
Dhe këmbëkryq mes nesh e ule
Karl Marks
në këtë pikë të planetit.

Kaluam vitet, na mësove
si të sfidojmë

shantazhet, llohët,
të thjeshtin emër na e bëre
të njohur në çdo cep të botës.

Dihet, emrat
Artan a Beni
asgjë nuk i tregojnë askujt.
Por themi thjeshtë: — shqiptar!
dhe popujt
na zgjatin duart me «salut»!

Merr fjala jonë vlerë e peshë,
mposht bujë,
zallahi e zhurmë;
popujt vënë veshin —
(S'flas unë, a tjetri)
Dëgjoni:
Flet Parti e Punës!

Dhe ballë larë bëjmë tutje,
krenarë ecim përmes kohës. —

Ja ç'nder i madh të jesh shqiptar,
të jesh ushtar i Enver Hoxhës.

ATDHEU

Poshtë këtyre mjegullave,
që derdhen si oqeanë nën krahët e avionit,
është mrekullia e të gjitha mrekullive —
Toka.

Ajo përbëhet prej disa malesh, qytetesh e lumenjsh
me emrat Alpe, Tirana, Shkumbini, Zagoria
ose shkurt —
Atdheu.

Ajo përbëhet prej disa djemsh e vajzash
me emra që ju të gjithë ua dini
ose shkurt —
Shokët.

Ajo përbëhet prej një vajze me emër prej drite
ose ndryshe
(që ju ta mbani mend lehtë) —
Dashuria.

Ajo përbëhet prej një gruaje që është mbuluar
me dhe
për të mbetur përjetësisht bijë e tokës që e lindi.
Mjegullat e bardha kanë diçka
nga qumështi i saj i gjirit
dhe malli e dridhja ime e tanishme,
kanë diçka nga duart e saj mbi flokët e mi.
Ka një emër të barabartë me tokën —
Nënë... .

Çdo fije bari që përkundet atje,
çdo qytet që gjallon,
çdo njeri që rritet
e humbet emrin e vet
dhe mban emrin e madh
Shqipëria... .

Të gjithë janë atje,
aeropot i vetëm
ku do të ngjitem e ku do të zbres
për jetë të jetës... .

KËRKIM

Sot në mëngjes dëgjova qyqen
«ku-ku».

Brofa në këmbë i dridhur.

Fëmijnia ime
varur mbi një degë lisi diku në kodriet e Zagorisë
zgjati kryet e më thirri.

Por unë s'e ndoqa më pas. Ç'kuptim do të kish? Ajo
iku.

Me një palë pantallona doku ngjitur pas kërcijve
të këmbës,

me një tufë keca përpara
(a thua më e madhe të ketë qenë se një tufë vjer-
shash?),

me një copë bukë ngjyer me gjalpë
(djersa e nënës sime?),
me vrapin e çmendur pas rrugës së diellit,
që kur lindte e gjersa kapërcente malet,
dhe me mendimin e pandërprerë, me kureshtjen e
fshatarit të etur:

«Ku vete dielli pas atyre maleve,
ç'ka andej;
ç'bëhet? ...»

Matanë maleve
ish një qytet me emrin e habitshëm Gjirokastër,

një botë ku ngjisnin çudira,
atje dielli si një e verdhë veze
mu në tiganin e kuzhinës, ku punonte babai,
natën këputej e binte...

Skuqej e përflakej kureshtja ime.

Dhe një ditë ika, ika
pas rrugës së diellit.

Sa vjet kanë kaluar qysh atëherë
sa male kam kapërcyer,
sa qytete?

Me të gjitha u mësova
dhe bota e përtej maleve të vendlindjes
m'u bë një botë e zakonshme,

atje m'u forcuan eshtrat, atje hoqa briskun e parë
në faqe,

atje mora paret e para të djersës sime
e bleva me to këpucët e para për rrugët e gjata,
për xhadetë dhe malet e larta.

Ata njëri pas tjetrit ngrihen e zgjaten
duke të thirrur të ecësh akoma
të shohësh, të flasësh...

të flasësh...

BIOGRAFI PËR TOMKË LAÇKËN

Në tavolinën time fotografia e saj
dhe jetëshkrimi:
«Lindi në Pogradec,
doli partizane
dhe ra në fushën e betejës kur ishte 14 vjeç».

Ejani, nëna,
nëna që lindni
gjithçka ka të bukur e të vyer
jeta!
Shtoni secila nga një rresht
dhe ribëni Tomkë Laçkën!

Se na mbeti Tomka pa jetëshkrim,
askush s'di gjë për të
të gjitha i mori plumbi.

Nëna,
mblihduni të gjitha dhe ribëni jetën e saj
ashtu siç dini vetëm ju të bëni jetën!

Si qeshte edhe pse s'qeshi, kur kish kohën e qesh-
jeve?!

Si u rrit dhe pse mori pushkën e doli malit,
kur kish kohën
të mbillte karafite në pezul të dritares?!
Pse e mbuluan plumbat trupin e saj,
kur duhej ta mbulonin tufat me trëndelinën
e livadheve të Pogradecit!
Kush i mohoi asaj të drejtën të bëhej
nuse,
nënë,
gjyshe!
(S'po flas për të tjerat — për koncertet, ndërtimet,
librat, fjalët dhe stadiumet).

Nëna,
kur secila prej jush këto t'i mësojë saktësisht
pa harruar asgjë,
me siguri emrat e Tomka Laçkave
do të kthehen
në një gji të tretë në gjokset tuaja.

Dy të parët do të mëkojnë qumësht,
i treti —
lirinë!

DJEMTË E UZINËS

Këta djem ka kohë që i gdhijnë netët
mbledhur kokë më kokë.

S'i mundon ata pagjumësia e shpirtit të plagosur,
nuk dijnë ç'janë vrasjet e netëve,
endjet nën hënë
rrugicave ku mjaullijnë macet e marsit.

Sa është ora? Dhe sa do të gdhijë?
Flini tani, djem. Është shumë vonë...

Ylli i mëngjesit tani u mbështet mbi ballin e tyre
si një abazhur i vogël
që ndriçon projektet në ëndërr.

Gjumi i tyre është i thellë si deti
që del në breg
në kohën e baticës, herët.
Dhe vjen agimi...
Në sytë e tyre tani
janë ndezur zjarre të kuq, të vegjël.

Edhe disa netë akoma pa gjumë,
edhe disa netë akoma do ndizet
abazhuri i vogël i yllit të mëngjesit
dhe pastaj gati do të jetë gjithçka.

Përgatisni, pra, gërshtëret,
fjalën e rastit
dhe tufat me lule për ta!

USHTAR

Flokët të qethura zero
kapuçi i fëshfëshes mbi kokë,
sonte qëndron pranë vajzës
nesër pranë topit.

Do të shkosh ushtar
dy vjet të tëra larg,
nga emocioni vjeshta rrëzoi
gjethet e pemëve në park.

Se për ne më mirë do të ish
të mos ndaheshim kurrë,
ta kalonim gjithë jetën
në shkollë, në punë, në rrugë.

Po ja që kjo ndarje na duhet,
na duhet të shkojmë ushtarë
gjersa në botë jetojnë
dhe njerëz, dhe kanibalë.

PARISI

Balzaku papritur vuri re një ditë
se e kish përfunduar Parisin dhe Francën.
Nuk kish ku të vendoste më male të tjera,
as lumenj e fusha,
as qytete, katakombe dhe pallate luksoze.
Nuk kishin mbetur as ndjenja,
tipare e vese të tjera .
ç't'u jepte më për plotësim
vrasësve,
markezëve, varfanjakëve, hajdutëve, prostitutave.
Gjithçka kish marrë trajtën e vet
prandaj e anuloi projektin e tij të fillimit.

Thanë atëherë se ai vdiq
por ky ishte një truk i vetë krijuesit të madh.
Në të vërtetë
ai u ngjit në një kodër
dhe qysh atë çast vendosi të mos krijojë
më asgjë tjetër
vetëm vëzhgon krijesën e tij
dhe bën sipas rrethanave
ndonjë ndryshim apo retushim të rastit.

Pas disa vitesh, për shembull,
me rrëqethje pa se bota e tij kish marrë revanin.

Prandaj për të mos mbetur në limontinë e mëparshme
i zëvendësoi karrocën me automobilë e avionë
dhe thikat e pisqollat e vjetra
me raketa, tanke e bomba të shumëllojshme.

Në çaste të tilla
ndiente diçka nga xha Gorioi:
S'mund të rrinte pa u kënaqur tek
as Gobsekëve,
as Votrenëve.
U jepte, duke përtypur dhëmbjen, gjithçka kërkonin:
mjete dhe metoda më të përfeksionuara
për vjedhje,
luks,
mashtrim
dhe vrasje.

Përveç ndërrimit herë pas here
të modeleve të kapeleve dhe fustaneve
bëri edhe disa korigjime të vogla.
Intrigat e dikurshme të katakombeve të Parisit
i nxori në dritë të diellit,
tavolinat e rënda të kompleteve
i zëvendësoi me tavolina duralumini e plastike:
(pesha më e lehtë e trapezave

të zbuste disi
peshën më të rëndë të krimeve);

Përsa i përket shpirtit
s'e pa të arsyshme të shtonte asgjë të re.
Mbeteshin ato që qenë thënë...

Vetëm se tani
lumenjtë e dikurshëm të veseve qenë kthyer në dete
që përplaseshin egërsisht
mbi shkëmbinjtë e qëndresës,
të etjes për liri, barazi
e mbi gjithë flamujt e tjerë
pabesisht të përdhosur.

Por si krijues
kurrë s'e ka mbajtur veten për zot.
Përherë u ka hapur vend
emrave të tillë si Frans, Rolan, Eluar, Barbys,
u ka hapur vend
dhe i ka porositur rreptë:
ose krijoni një Francë e Paris
krejt ndryshe nga bota që krijova unë,
ose zhdukuni!
Plagjatë të vetes nuk dua.



Ndërkaq,

duke vazhduar të bëjë retushime të tjera,
shumë mund e nerva harxhon

duke u marrë me të tillë si

Rembo, Puankare, Bodler, Prust, Laval, Sarrot;

De Gol, Marshe

e me radhë...

— Mos u mashtroni, — thërret Balzaku i madh, —
këta janë djemtë e mi plangprishës!

Zhvishuani kostumet e maskat,

flakuani emrat e rremë

e do t'ju dalin lakuriq:

Votrenë, Grande, Nysingenë...

Tjetër kënd pret të vijë ai

dhe e ndien se krijuesi i ri është diku,

e dëgjon tek rënkon, tek mbledh grushtet, gjëmon...

Atëherë Balzaku i zbardhur

rrugën do t'i hapë

dhe vetë madhështor do të tërhiqet

përfundimisht

në Panteon.

NUK NA LEJOHET TË LODHEMI

Nuk na lejohet të lodhemi,
është kohë stuhish të rënda
luftë zhvillohet jashtë
luftë zhvillohet dhe brenda.

Është kohë e ashpër, vëllezër,
s'synohen thjesht kokat tona,
armiqtë me ne kërkojnë
të mbysin revolucionin.

Dhe derdhin ata të tërbuar
gjithë lukuninë e armëve
dhe xhaz dhe atom edhe bibël
të puthura, ngërdheshje dhe çmendje.

Ejani, — thonë, — ja bota!
Ejani, — thonë, — ja jeta

me mini, me maksi, me izma
kufijtë «çita aperta».

Ejani, ejani, ejani,
ka ikur koha e vjetër,
është koha kur bëhen vëllezër
izma e fundit
me patriarkalizmin me mjekër.

Të gjithë në njëshkolonë
lëshojnë gjithë bateritë,
s'synohen thjesht kokat tona
synohet socializmi.

Ndaj s'na lejohet të lodhemi,
lodhje do të thotë vdekje.
Fjala është për socializmin
dhe jo për vetveten...

PAS SHFAQJES SË NJË PREMIERE

Ra perdja,
gjëmimi i duartrokitjeve
Shtyn muret, tavanin.
Diçka e re hyri këto dy orë mes nesh...

S'na nxë më salla.

JEHONA

Prapë u ktheva tek një vjershë e largët
rrahje e parë e zemrës s'mbahet fshehur,
tridhjetë vjet nga jeta ne na shkuan
mund të rrojmë ndofta dhe një shekull.

Dhe në dejet që mbushin atdheun
ndodh që të të shfaqem përsëri,
do pyesësh dridhshëm:

— Ç'ke, moj zemër?

Do përgjigjet zemra:

— Është ai.

Po, moj, po, jam unë ai shkollari
që dikur me aq zjarr të desha,
ti a s'je ajo vajza e Palortosë
që bleroi kaq vite ndër vjersha?

S'ka mes nesh asgjë që të na skuqi
askërkund s'rëndon rini e pastër.

Unë të desha ty siç desha rrugët,
pemët, njerëzit, gjithë Gjirokastrën.

Ndaj e di,
askush nuk do pengoj
kur në shpirtin tënd të hynte thellë,
s'do të pyeste:
— Ç'janë ato gjurmë
si qytete shembur në humnerë?

Se atëhere veç sa kishte nisur
të përplasej zemra si mëllenjë,
ti tek unë dot s'i ngrite muret
unë tek ti dot nuk i hodha rrënjët.

Ishte vetëm një trokitje e parë
në imazhin e një qyteti të kaltër,
sidoqoftë për mua ti mbetesh
e bardhë dhe e shtrenjtë si Gjirokastra.

1972

RADHA

E hoqa dhe një fletë nga kalendari i vitit
dhe m'u drodh dora.

Pashë si po shkëputeshin nga trangu
tridhjetë ditët
e lodhjes së mëngjeseve dhe mbrëmjeve,
tridhjetë ditët e këngëve, shqetësimet rrugëve.

U përmendën ato ditë
në qindra biseda, në qindra letra,
u puthën në mijëra takime,
lindën fëmijë e prodhuam çelik e bukë.
Ishin epiqendra e vëmendjes,
kudhra e botës.

Por erdhi çasti të bien këto ditë,
muaji i ri, me rrënjë në tabanin e tyre,
po troket nëpër portat e kohës.
Dhe ato të thjeshta e madhështore largohen
s'mund t'u mbyllin
të tjerave horizontet.

MILITANTI

Kur panë se ai s'jepej
edhe pas torturave të llahtarshme,
vendosën ta dekurajonin.

I prenë gishtat...
Më s'kish se si t'i binte violinës
as ballin e nënës dhe flokët e gruas s'do të mund
t'i prekte.

Dhe as hundën e fëmijës
s'do të mund ta shtypte dot lehtë
mbrëmjeve
kur të kthehej nga koncerti i madh i Lirisë.

Por këto qenë gjëra të së nesërmes
përpara kish punë më urgjente:
me se ta zbraste pushkën kur të ikte nga burgu,
me se ta mbyste fashizmin?!

Duke vrarë mendjen për këto
i gëzuar ndieu
se këtë mund ta bënin sytë.

Iu bënë më tepër depërtues, më të egër,
shikimet e tij të prisnin si bajoneta
të godisnin si plumba.
Ato shikime me siguri
nesër do ta tërhiqnin këmbëzën e armës.

Atëherë, të tërbuar ata,
ia nxorën të dy sytë.

Tani armiqtë e dinin se edhe për ta
ai qe fare i pavlefshëm.
Edhe sikur t'u jepej
s'do të dallonte dot asnjë shok ilegal,
s'do t'i udhëhiqte dot në asnjë bazë të fshehtë,
në asnjë shteg për te luftëtarët.

Por ai e ndieu
se akoma e akoma kish me se të luftonte.
Do të dal nëpër rrugë, mendoj,
duke u mbajtur pas mureve
ose duke më marrë fëmijët e të vrarëve për krahu,
do ta bëj fjalën të jetë goditëse si plumbi,

frymëzuese si flamuri.

Një fjalë e tillë, sigurisht, arrin të tërheqi edhe
çarkun.

Atëherë ata ia prenë edhe gjuhën. . .

Tani edhe të donte

s'tradhtonte dot asgjë

e s'thosh dot asnjë fjalë për ato ç'kërkonin.

Dhe, thanë, fashistët se më së fundi mbaroi çdo gjë
e u tërhoqën të dërrmuar:

Por të nesërmen ata të tmerruar

panë se ai

përsëri qe gjallë.

I rëndë e madhështor si një copë shkëmbi

lëvizte nëpër qeli

si drejt malit nga e kishin këputur.

E kish quajtur të dënueshme të vdiste

gjersa i kish mbetur për luftë

arma e vendosmërisë për të jetuar. . .

FLORIRI I HESHTJES

Është një flori që s'futet në kuletë,
floriri i heshtjes.

Atë as gruas në qafë s'mund t'ia varësh
as në dyqan gjësend s'mund të blesh.

«Hesht!

Edhe atëherë kur s'mund të mos flitet
Hesht!

Edhe arrë mbi kokë në të thefshin
Hesht!

Edhe atëherë kur vetë heshtja flet
Hesht!

Edhe në të goditshin ty, shokun apo klasën
Hesht!»

Daulle e shqyer e një mikronjeriu,
Fati yt —

të kalbesh në skutën vetmi.

Në rrugën tonë që rreh e tund kohët
ti mjaullin:

«Heshtja është flori.

Ç'të duhet, thua, të ngatërrosh?
Ka të tjerë që e bëjnë politikën e madhe,
shiko punën tënde ti
përse të rropatesh në aksione, nëpër mbledhje, de-
bate!

Heshtja është flori...»

Është një flori që s'futet në kuletë
por në e kërkofsh
në qafën e ndërgjegjes si shushunjë kacavirret.
Të bën të kesh frikë edhe gjuhën amtare,
të bën t'i trembesh edhe gjumit
me mundësinë e befasisë për të tradhtuar vetveten.

Duke u ruajtur tinëzisht nga korentet,
nën ulërimat torturuese të gojës së kyçur
mbaron së qëni njeri,
bëhesh
heshtje...

POROSI ARTISTËVE QË VIJNË

Në u dashtë ndonjëherë të më bëni portretin
mund edhe ta hiqni kalin prej meje,
s'do të qëndroj gjithmonë mbi kalë
E megjithatë edhe pa të
do të jem
Skënderbeu i gjallë.

Vetëm pa shpatë kurrë mos më lini,
mos më lini pa shpatë — pjesën time të trupit
Pa të
harresa do t'ju mbulojë,
dhe turpi.

KËTË TË THJESHTË GJË MËSO

S'kam se si të mos revoltohem
kur mësoj nga të erdh ky pasion,
ngaqë s'paske në fshat ç'të bësh tjetër
ke vendosur të jesh poliglot!

Ikin nxënësit dhe ti merr fjalorët
mbyllesh brenda i heshtur pa zhurmë,
por na thuaj, ku vallë dallon
jeta jote nga jeta e murgjve?!

Por na thuaj, për ne çfarë viere
do të kenë këto gjuhë të shumta
kur ti s'di ç'do të thotë shqip «grurë»,
kur ti s'di se ç'halle ka fusha?!

Kur ti veten krejtësisht ke ngujuar
zhytur mbi sufikse dhe trajta,
krejt i ftohtë ndaj çdo tingulli jete,
krejt i huaj për gjithçka ndodh përjashta?!

Ndaj të themi — lidhu me jetën
nëse s'mundesh, u lidh me pahir
se fshati s'është teqe dervishësh,
se fshati s'është manastir.

Se fshati s'ka nevojë për murgjër,
front lufte është ai sot.
Mëso ti gjuhë por më përpara
këtë të thjeshtë gjë mëso!

GURI I LOTËVE

Është një gur i murmë në një shteg të Shishtavecit —
Guri i lotëve.

S'u këput ai nga ndonjë shkëmb i maleve tona,
s'doli ai nga tabani i tokës.

Ikni djemtë me strajcën e shpresave mbi shpinë
pikë-pikë rridhnin lotët tek shtegu
dimrit të gjatë si vuajtjet
verës së shkurtër si ëndrrat.

Pikë-pikë, pikë-pikë
dhimbja e nënave
malli i nuseve, motrave
dhe dalngadalë u ngurtësua në anë të shtegut ky gur,
koncentrat tragjik i kripës së lotëve.

Uleshin korbat mbi të e çukisnin me sqep
pastaj ngriheshin e lëshonin «krrrau-krraun» e fu-
ndit të jetës,
lëpinin me gjuhë dhitë e egra sipërfaqen poroze të
tij
dhe këputeshin të helmuara
honeve.

Gur-stranicë,¹⁾
gur-sinor
midis jetës dhe vdekjes,
midis kohëve —
ti i tillë do të mbetesh në shtigjet e kujtimeve tona,
Gur i lotëve!

1) *Pllaka që vihet në krye të varrit.*

QETËSIA IME

Qetësia ime është si lumi
që mbledh rrëketë gjithandej,
veç kur lëviz, kur jam mes njerëzve
të qetë veten unë e ndiej.

Ndaj dal në rrugët e atdheut
mes arave, kantiereve
atje ku çan traktori brazdat,
ku fre u vihet dallgëve.

Ku uturijnë njëqind makina,
ku nxjerr uzina tym duman,
ku gruri çan njëqind bllokada
në shtratin tim e shoh se jam.

Dhe rritem, bëhem më i qetë,
ju ngjaj më shumë, miqt' e mi,
ju bij të lindur nga shtrëngata
në këtë kohë pa qetësi.

FILLIM I MËSIMIT

Vajza ime e vogël, e vogël katër vjeçe
fjalën burokrat
e shqipton në mënyrë të tmerrshme.
«Burrkërrkrrak», thotë e vrejtur, «burrkërrkrrak»
(ka parasysh krimbin
që bën «kërr» nën krevat).

Moj bijë, i them, e vogël, e mitur
burokrati
vërtet është krimb,
veç disi më i rritur.
Në e lënçim të qetë, ai pak nga pak, mojt bijë,
ha krevatin tënd,
mua e ty,
krejt shtëpinë...

Vajza hap sytë, ngultas më sheh
dhe si fëmijë që është
nis nga «përsetë».

Përse u fut në krevat ky krimb?
Përse ti, babi, s'e djeg me benzinë?
Dhe qysh mundka ky gishto
i vogëlzë fare
të hajë një shtëpi
kaq të fortë, kaq të madhe?!

Marr vajzën në krahë, përpyetë e hedh
— S'do mundi kurrë!, — me bindje i them —
dhe që ti të mësohesh si luftohet sadopak,
le ta nisim me këtë krimb
që bën «kërr» nën krevat.

*
* * *

Sekondat e ditëve të mia
më pyesin nga mëngjesi
gjer në fundin e mbrëmjes
dhe presin përgjigje...

— Ç'bëre për këta njerëz, për këtë vend?

Sekondat e jetës sime janë gjykatës të rreptë
dhe ndërgjegja ime
një sallë debati ku shpesh s'mbyllet as edhe një
moment.

MALET USHTARË

Në Majën e Hekurave
mes borërave
dhe ndryshkut
kalben avionë armiq
të luftës së fundit.

I kapën avionët
në fluturim e sipër,
majëmalet tona
kundërajrorë të lavdishëm.

FILLIMI

Jo në këtë mënyrë, jo në këtë mënyrë, thua e tro-
nditur
ndërsa unë vij e të flas
duke sjellë në vend të procedurave më të qëndru-
eshme
vetë zemrën.

E dashur,
dashuria nuk është një orë mësimi,
dashuria s'mësohet në dispencë,
ajo është gjaku që lidh
malet me detet.

E dashur,
kot e ke që kërkon metoda.

Unë të dua ty se s'mund të mos të të dua
vij drejt teje se s'mund të rrij pa ardhur
shkurt:
të dua, të dua, të dua!...

PËRGJIGJE

Ndali para grykës Valbonës
gjenerali Veshoviq taborret
dhe i nisi lajm Muzhak Haxhisë
komandantit trim të kryengritësve.

«S'dua tjetër gjë, veç pesë pushkë
të m'i çosh si shenjë paqëtimi
dhe pastaj ushtrinë e kthej mbrapa
kryet nuk ua var në dega pishash...».

E ka marrë kapedani lajmin
dhe i thirri burrat të vikasin:

— Veshoviq, or thi, me emër shkjav,
gratë me barrë i kemi tek shtëpia...

Nuk të çojmë as pesë fije bari,
nuk të çojmë as pesë gjethe ahu,
nuk të çojmë as pesë gurë mali,
nuk të çojmë as pesë pika uji
vetëm pesë krisma prej alltije
të dërgojmë
t'i vesh në rrëzë të veshit...

Futju, pra, ti grykës së Valbonës,
gryka quhet
gryk' e Dragobisë
Ta tregojmë këtë që t'u çosh fjalë
krajlave
se ku të ta gjejnë varrin...

ISHULLI I QENVE

Ishulli Margëret
Budapest 1972.
Bora e bardhë
Danubi i zi.

Këtu mbreti Zog fjetei natën e parë
me Geraldinën,
princeshën maxhare.

Kanë shkuar vite
dhe në ishull përsëri
zonjat ndërsejnë qentë
të bëjnë «dashuri».

Rrotull huliganët
duartrokasin me ëndje
spektakël modern
ishulli i qenve...

«**MBRËMJE NË TIRANË**»

Eci buzë mbrëmjes i bërë një me këtë peizazh,
me këta njerëz, me këtë perëndim mbi luginë, me
këtë mal.

Ç'gjë e bukur që mendoj e flas shqip
ç'gjë e bukur që jam shqiptar!

RRËNJËT

Ka diçka që s'ma plotëson qyteti
mua që linda në fshat.

Më vijnë gjer këtu zërat e lartë të fshatarëve
sikur bisedonin jo thjesht me njëri-tjetrin
por me malet;
më magjeps çiltërsia e syve të tyre
sikur të derdheshin që andej
jo thjesht shikime,
por ujëvara;
më rëndon e më dredh shpesh feta e bukës
sikur në duar të mbaja
plisa...

Dhe unë e di se ky s'është trishtim,
nuk është shpirt i vogël mikroborgjezi.

Sepse unë kam lindur në fshat
dhe djepin me dru nga lisat e atjeshëm ma bënë,
dhe faqet era e atjeshme m'i rrahu,
dhe të flas shqip atje mësova.

E në i harrofsha të gjitha këto
m'i prisni gjer në rrëzë këmbët!

TI

Kërkon vetëm të të lemë të qetë,
të të lemë të lirë në rrugën tënde,
sepse askujt s'i rënke në qafë,
sepse shtetit asnjë fije s'i rëndesh,
sepse flokët e gjata do t'i mbash mbi supet e tua
dhe pantallonat kauboj mbi gjunjët e tu,
sepse muzikën që të pëlqen e ke për konsum vetiak
dhe mënyrën si do të sillesh — po kështu.

Ti habitesh kur të dalim përpara,
kur të themi: «Jo!», kur të shpjegojmë «pse...»
dhe s'do të kuptosh se,
megjithëqë edhe pa ty socializmi ndërtohet
prapëseprapë,
pengesë për socializmin ti je.
Je pengesë sepse qetësia jote
është qetësia e insektit në fazën e pupës,
në të lënçim të qetë që andej do të dalin
lukuni mikrobesh që do na helmojnë rrugën;
në të lënçim të lirë në «liritë» e tua,
prej vetes do të humbasim diçka pak nga pak
qoftë kjo dhe një minutë mungesë në punë,
qoftë kjo dhe një britmë çjerrëse në park.

Pa dyshim
të gjitha këto ne s'kemi si t'i lëmë,
s'ka nevojë të na thuash
«Në i bëj dikujt dëm, këtë ia bëj vetes».
Në luftën tonë s'mund të rrish mënjanë,
e tillë është dialektika e jetës.

DITË MBJELLJESH

Dua t'ju përqafoj të gjithëve
në këtë ditë tetori me diell të mrekullueshëm

Tek dielli i kësaj dite tetori
janë dhjetë mijë hektarë pranverë,
dhjetë mijë parcela të gjelbëruara prilli,
dhjetë mijë hambarë të mbushur,
dhjetë mijë llogore të fituara...

Jam mes jush
që me djersën e ballit
mbillni qysh tani prillin dhe korrikun!

LONI DHAMUA

Tridhjetë ditë me radhë e grinë dhe e shpuan,
tridhjetë plagë
si tridhjetë gojë i hapën
e megjithatë, nga të tridhjeta
vetëm gjaku
dhe heshtja
ranë...

«Fol!»

e hoqën zvarrë gjer në shesh të qytetit
dhe vetëm kur grykat e pushkëve ndieu në ije,
Prisni! — tha, —
U mat të ngrihej.

Çoi kokën dhe koka iu përplas pas gurëve,
çoi trupin
e trupi iu përplas si një trung i bukur lisi;

prapë ra,
prapë u ngrit
gjersa e ndieu veten të fortë
e tokën nën këmbë.

Qyteti e malet tani qenë në duart e tij,
jetën dhe xhelatët
i kish përpara të tërë,
— Tani qëlloni! — tha
dhe plumbat i priti më këmbë.

Është një shkollë në Lushnje me emrin Loni Dhamo,
luftoi një batalion partizanësh me emrin Loni Dhamo,
zgjatet një rrugë në Lushnje me emrin Loni Dhamo,
rriten fëmijët në një kopsht me emrin Loni Dhamo.

Loni Dhamo!

NGROHTËSI

Kapërcyen qafën e Çajupit makinat e druve të zjarrit
duke nisur drejt qyteteve të jugut
si drejt frontit
pjesë nga Dërmazi...¹⁾

Miq, kur të vijë dimri,
kur borërat do të ngrijnë rrugët dhe hapësirën
mos harroni:

Ju duart e mardhura
s'i zgjatni thjesht mbi pore e soba,
mbi trupin e ngrohtë të Zagories i shtrini...

1) pyll në Zagorie.

« SINORËT »

Por ti shumë vonë, shumë vonë
je kujtuar të shkruash për zhdukjen e gjerdheve,
ju mund të thoni.

Mund të thoni kështu.

Por dje,

ndërsa traktori çante parcelat e mëdha të koopera-
tivës;

plugjet mend copëtoheshin

nga gurët e nëndheshëm të ish-gjerdheve.

Ata dilnin fare papritur

si mina të futura nën themele që nga lufta e fundit.

Atje, të rrezikshëm, për shumë vjet akoma

do na gllabërojnë djersë

dhe pjesë këmbimi...

Por kaq është e keqja më e vogël,

rrënjët e pronës janë akoma më të tmerrshme.

Në i lënçim në heshtje gjithçka mund të helmojnë

siç helmojnë nganjëherë krejt trupin

rrënjët e një dhëmballe të shkukur para shumë
vjetëve...

← GURI I RRUMBULLAKËT →

Guri i rrumbullakët
pa majë,
pa kënde
sido që të ndodhë, diku do të gjendet.

Gur meskin
i mbyllur në vetvete
pa funksion thuaj fare,
ai as në themele, as në qoshe të murit s'qëndron,
as në prag të portës
dhe as në dritare.

Dy luftëra të egra
u bënë këtë shekull,
dy herë nga themelet u dogj kjo shtëpi
pluhur e hi u bënë gurët heroikë të mureve
rrumbullaku e shpëtoi kokën e tij.

Dhe ja ku prapë,
si të mos ketë ndodhur gjësend,
u ngjit ai
edhe në apartament.

Vajza e vogël e përdor në vend të brumbullit
(ç'ofezë
për botën e mrekullueshme të gurit!)
Nëna plakë
me të shtyp hudhra dhe qepë
por ai s'preket,
s'ëndërron lartësitë
veç të ruaj qoshen e tij të qetë, të qetë.

S'ke nga e kap.
Gur pa shpirt,
i lëmuar, i ftohtë
«Ç'ke me mua?! Unë s'bëj gabim!...»
Duket sikur të thotë

E shoh dhe dridhem
do ta flak në humnerë
këtë krijesë të mjerë.
Dhe e di:
për të shpëtuar kokën,
rrumbullaku, nga pas
lë gropën!...

^eSTATUJAT ₇

Këputa një zambak të bardhë në Apolloninë e Fierit
rrëzë rrënojave
të qytetit prej statujash.

Vetëm era e ngrohtë e prillit ato çaste frynte
sikur t'i thoshte «Zgjohu!»
botës prej mermeri.

Dikur, si degët e këtij zambaku,
krahët u kanë këputur statujave,
kokat u kanë prerë statujave,
qytetet u kanë rrënuar statujave.

JORGUA

Nga Dhëmbeli fryn era e prillit,
mëngjesi i pastër si xham,
kalon Jorgua me një trëndafil në dorë
dhe një vajzë të fshatit e shan.

Nuk ke turp? Na je dhe zagorite,
je edhe bujkeshë me kaq nam,
ti ia hoqe zemrën kraharorit
ke në vend të zemrës trotuar.

Po kujt do t'ia lesh ti këto ara,
këtë mal, këtë qershi dhe lis?
Era e Çajupit s'të vjen prapa,
s'të vjen prapa baltë e Zagories.

Blegërimë e shqerrave në mbrëmje
mbledhjet e rinisë natën vonë...
Budallaçkë, asgjëkund s'do gjesh
dashuri si dashuria jonë.

Kot ta fryjnë, pra, mendjen se qyteti
qenka një dhe s'paskërka të dytë
dhe këtu ka djem dhe... ç'djem që janë,
nuk i sheh? Mos të kanë plasur sytë?

Kot ti veten, pra, kaq shumë ndrydhe,
veç një herë në jetë ka rini...
Kalon Jorgua me një trëndafil në dorë,
me kë vallë ka rënë në dashuri?!

FUND QERSHORI

Të gjithë kanë ikur.
Mbeti qyteti më gazmor në botë
si në dimër drurët gjetherënës,
përplas heshtja në dhomat bosh
copëra leksionesh, dashurish dhe këngësh.

Të gjithë kanë ikur.
Gjer nesër në mëngjes i mallëngjyer do të rri,
si ky qytet studentesk i zbrazët gjer në vjeshtë.

GJIU I VLORËS MË KUJTOHET TANI

Gjiu i Vlorës më kujtohet tani
me ujin e ngrohtë të gushtit.

Portokallet ende aguridha
dhe shikimet e tua krejt erë
tepër herët qe për dashuri,
tepër herët.

Tani plazhi krejt i zbrazët ka mbetur,
Shtrydhin retë qiejt
siç shtrydhje flokët ti.
Natyrisht nëse atë gusht ishte tepër herët
tepër vonë është këtë dhjetor për dashuri.

Por ti dil, o dil në breg të këngëve,
dashuri s'do të thotë të duash thjesht ty,
të dashurosh do të thotë të lidhesh për jetë
me këta njerëz, me këtë breg, këtë gji.

CABO KORVUERO ⁷⁷

Në Kepin Korvuero, pika më perëndimore e Kontinentit Evropian, ndonëse deti në sipërfaqe duket krejt i qetë e i ndritshëm, fare papritur ngrihen dallgë të mëdha që gllabërojnë gjithçka gjejnë në breg. Për këtë portugezët kanë vendosur tabela metalike ku shkruhet: «Kujdes! Këtu deti të mashtron!»

Det me bukuri magjepsëse,
breg me të gjitha shkëlqimet.
Ja vilat, pallatet mes pemësh
lundrojnë në lumë veturash.

Por ki kujdes, ti, kujdes
të fshehtë e këtij kepi:
prapa bukurisë fshihet
gllabërimi i detit.

Në heshtje përkulesh ti
te busti i De Gamës
por në vend të Vaskos del
vetë Salazari.

Nëpër reklama damat
konkurojnë me lopët
sikur qumështi «mbyt» Lisbonën
«Mrekulli e tokës»!

Por kujdes këtu, kujdes,
është Kepi Korvuero,
ky imazh fantastik
mashtues si deti.

Ku është Margarita,
ku janë Eriko, Grigores?!
Rrugët demonstrojnë,
liri Zhoze Jorges!

Demonstrojnë pemët, dallgët:
Liberdadë! Liberdadë!
Në bidonvilet poshtë
mizerja kalbet.

Gra pa fjalë si hardhi të prera.
U pikojnë sytë, duart,
prostitucioni tani
përfshirë ka dhe urat.

Nga bregu shën Maria
premtion rrugë të mbarë,
Atlantiku gjëmon,
kërkon të hajë.

Kërkon gjak fashizmi
uzinat duan skllevër

televizioni më tepër shkëlqim,
Kunjali pushtet.

Në Alentezh tokat
kërkojnë plugje dhe farë,
peshkatarët ose peshqit
njëri-tjetrin të hanë.

Por rrugët prap' gjëmojnë
Liberdadë! Liberdadë!
Vranë dhe mbesën e Margaritës
dhe djalin e Zhozes e vranë.

Dhe përsëri shkëlqimi
me mjerimin tallet:
sa të ketë mbivlerë
do të ketë Salazarë!

...

Portugali e bukur,
e ndritshme dhe e mjerë
nën divizën e madhe
Cabo Korvuro.

«TEK KJO PORTË ËSHTË DASHURIA»

«Tek kjo portë është dashuria»
këndonte mbrëmë vonë një djalë në një rrugicë të
Tiranës.

Porta ish fare e zakonshme
me dru lisi nga koriet tona
muret qenë prej qerpiçi nga balta shqiptare.

E pikërisht pas asaj porte, prapa atyre mureve
mbyllej dashuria e një djali...

— Eja, — i thashë unë, — t'i vemë supet portës e
ta rrëzojmë,
eja, — i thashë, — t'i vemë krahët murit e ta he-
dhim matanë.

Për këtë koriet tona nuk na zemërohen,
nuk na zemërohet balta shqiptare.

“BOTË E VOGËL M’U LARGO !”

M’u largo, botë e vogël,
me shqetësimet e tua vulgare:
duhen perdet kështu
dhe fustanet ashtu
dhe filani me filanë që ndahen
dhe të flasësh kështu
dhe të ecësh ashtu
dhe të krihesh kështu
dhe këtë e këtë e këtë
nga mëngjesi në mbrëmje...

S’të dëgjoj!
Veshi im
ato fjalë s’i kap kurrsesi.
Linda unë në kohë stuhish
të rroj ndryshe
as mund, as nuk di.

Të shqelmoj,
botë e vogël,
me shqetësimet plot erë kuzhine!
Tej tek kthesa
më thërresin të nisem
nëpër rrugë
boritë e makinave.

1972

NATA E DASHURISË

Natës u nisa dhe unë për tek ti,
natë shkurti me lëvizje të çrregullta resh
ti hap deriçkën ngadalë e më hidhesh në gjoks
krahët për supesh m'i hedh.

O, po sonte jam kaq i trishtuar, e dashur,
megjithëse ndodhem pranë teje,
unë e urrej këtë takim natën
ngujuar me misterin e shekujve.

Ngjaja si hajdut kur lëvizja rrugëve
(sikur vija të thurnim një kurth a komplot)
a s'më thua nga kush vallë ruhem,
a s'më thua nga kush na vjen zor?

Se më dukej sikur fshatit ne sonte
do t'i rrëmbenim diçka padrejtësisht,
a s'më thua kam të drejtë të të dua
dhe a mundesh ti larg meje të rrish?

Ndaj eja të dalim në mes të fshatit
atje jeta është krejtësisht e re,
Nëse nata dikur qe mburojë e dashurisë
tani s'është tjetër veçse ferecë...

1971

⁶**PRITJE** *π*

Do vijë ajo sonte nga viset jugore
ndaj mua zemra qetësi nuk më gjen.
Përse aq të gjata më duken leksionet,
përse aq ngadalë sot dita po kthen?

Patjetër do vijë. Në vend më s'më rrihet
se nisem diku, nuk di më ku shkoj...
Se vjen ajo sot. Tek hyrja e stacionit
një copë vendlindje në gjoks do shtrëngo.

1967

TI MË SHKRUAN...

(Një të njohuri...)

Ti më shkruan se je mërzitur larg qytetit.
«Ditët nuk ecin...»

Edhe një ka do të qe trashur kështu
e s'do të bënte më për parmëndë.

Ndaj unë të them, merru me diçka,
me çdo kusht të bësh diçka që t'i vlejë fshatit...
Në s'di të shkrihesh mes njerëzve,
me gëzimet dhe hallet e tyre,
(qofshin këto për ditët e punës
apo shiun që s'bie)
atëherë merru me diçka më afër forcave të tua.

Në je vetë më poshtë
ngjitu tek më i miri djalë i fshatit.
Të gjithë bashkë do të bëni çudira
dhe jeta do të jetë e mrekullueshme.

Ose shkruaj me pasion historitë që tregojnë pleqtë,
mblidh këngët popullore, legjendat,
ngri një mur me nxënësit në kohën e lirë
ose mbill të paktën një pemë.

Edhe nëse asnjëra nga këto
përsëri gëzim s'do të të japi
atëherë,
papritur të të thotë askush, —
dorëzoja diplomën të parit brigadier
dhe nise gjithçka nga e para...

Dhe mos e merr këtë aspak për dënim,
nëse vërtet do të rrosh si njeri midis njerëzve.

T'i them këto jo thjesht për të mos u shkëputur nga
por për të mos u shkëputur nga jeta...
fshati

«HARMONIA»

O, sa tmerr, sa tmerr do të qe
sikur unë me dashurinë time të shkronim
ëngjëllisht në harmoni!...

Të më thosh:

«I dashur, flemë?»

E unë menjëherë të flija.

T'i thoshja:

«Heshtim»,

e ajo në moment të mos kish më nevojë për gojën;
të më thosh:

«Dua lule të rralla».

«S'kemi ku t'i gjejmë» — t'i thoshja,

e asaj menjëherë t'i qeshnin sytë:

«kjo është e mrekullueshme, i dashur,
vërtet,

ku mund të gjënden?

S'kemi ku t'i gjejmë...»

T'i thoshja:

«Sonte duhet të dalim!»

«Jo» — të thosh ajo
e unë të hapja sytë
si para një zbulimi të padëgjuar:
«E dashur, me të vërtetë pse të dalim?
E ç'duhet shëtitja,
kush i ka shpikur rrugët? Jo, e dashur, jemi rehat
në kuzhinë».

Të ndodhte kështu,
me mua e me dashurinë time,
mbi trup s'do ta ndienim nevojën
e peshës së pafunksion të nervave,
as muret s'do të kërkonin
bojë dhe gëlqere...

Të ndodhte kështu, me mua e me dashurinë time,
në shtëpinë tonë s'do të dëgjohej asnjë zë
dhe gjumin asnjëherë s'do ta prisnin në mes
britmat e të porsalindurve...

ZGJOHUNI!

Fqinji im
bën gjumin e ëmbël
në shtratin e ngrohtë
pas perdeve të rënda.

Mesnata atje s'dihet ç'ngjyrë ka,
s'ndihet akoma kënaqësia e lodhjes së një nate pa
gjumë.

I gëzohet apartamentit
me erë gëlqereje,
apartamentit që s'u ngjason aspak të tjerëve.

Po unë shqetësohem,
unë kam frikë
mos fqinji kaq herët fle gjithë vitet.

Në ndodhtë kështu pas muajsh, pas vjetësh
ai s'do të njohi dot lagjen, qytetin.

Atëhere me siguri s'do të gjejë dot as shtëpinë —
i hutuar nga limontia
në dyert e të tjerëve gabimisht do të hyjë...

AMERIKA

Kësaj gruaje ka dyzet vjet që i ka mërguar burri,
dyzet vjet që ai mban emrin Amerikë.

Fytyra e tij është një zarf me anët të ngjyrosura,
goja e tij, ose buzët e tij, ose sytë e tij
janë pullat dhe adresa e shkruar në një gjuhë të
pakuptueshme,

trupi i tij është dy fije letër
«Jam mirë, lus të madhin zot që...»
Zëri i tij është një rënkim i thellë
që del midis humbëtirës së shkronjave.

Apo mos ky rënkim është zemra e tij?

Se zemrës së burrit gruaja akoma s'ia di formën...

1972

LARTËSITË

Po ngrihen lagje të reja me ndërtesa shumëkatëshe
nëpër lagjet dhe periferitë
e këtij qyteti të zhurmshëm.

Njëra pas tjetrës shtëpitë e ulta,
shtëpitë e kërrusura si gjyshe të urta,
nxitojnë të mbledhin plaçkat
të mbushin bohçet
(ah, nëpër to s'i mbështjellin dot kopshtet!)

Ranë muret rrethues të oborreve
postblloqe të rënda,
burgje të dritës.
Ne që grisëm ferexhetë nga sytë e motrave dhe
nënave

edhe këto mure
do t'i rrafshonim një ditë.

Gjyshe të dashura,
do t'ju marrim me vete
lart nëpër apartamente!

S'na duhen atje këto rrugica të ngushta
me lule anash e guriçka në mes,
nëpër rrugët e gjera të qytetit djalë
vërshejnë autobusa
dhe taksi urgjence:

Mos u trembni se biem.
Me lartësitë u mësuam,
kaq të sigurt ne ngjitemi drejt qiejve
vetëm e vetëm se kemi të patundur
tabanin tuaj...

SËMUNDJA E BUTË

Kundër teje, kobër e keqe,
lufta jonë s'ka finish,
futesh tinës, ngordh e ngjalle
veç të bresh edhe të grish.

Veshur ti me gjithfarë ngjyra
ëmbëlsisht i del diku
por e dimë nën lëkurë
tjetër gjë nuk je, veç ujk.

Thua «rri», i thua eja,
nëpër rrugë le të dalim
e përse ta ngrysh jetën
natë e ditë mbi «Kapitalin»!

Kokën shfaq në formë gote
që një dorë ia servir.
«Pije, mik!», veç ajo gotë
nesër kthehet në zinxhir.

Të shqelmojmë. Ti tulatesh,
mblidhesh, kërrusesh në një skutë,
por sapo dikush lëkundet
rishtas vjen, sëmundje e butë.

S'zemërohesh. Buzëqesh.
Ç'dredhje e përdredhje ke!
Sot e ul. Nesër i thua:
«Më i zoti je mbi dhe».

«Jepi, — thua, — ç'pret akoma
syno lart, kolltuk, karrierë»,
ngrihemi të zemëruar
mbi fytyrë të flakim derën.

Ngjeshim hapin. Qindfishojmë
angazhimin tonë në jetë
dhe s'pushojmë gjersa ty
të të shkulim rrënjë e degë.

KJO NDODHI NË GUSHT

Kjo ndodhi në gusht
në sallën e koncerteve
të zhytur plot dy ditë në zagushi.
Në mes diskutimeve të dërsira
zërin ngriti një i ri.

Shokë, tha,
prej vapës së madhe
Tiranës i rrezikohen bimët e mbjella gjatë pran-
verës

Propozoj:
siç jemi të derdhemi fushave,
atje t'i vazhdojmë seancat e tjera të mbledhjes.
E zgjatëm shumë,
i buhavitëm të gjithë abcdi-të.
Me lëngun që na avullon apo na thahet nën gjuhë
mund të kishim ujitur dy hektar misër.

Këto kisha, shokë,
dhe tani le të marrim një vendim të përbashkët:
Kush kërkon të derdhi akoma ujë mbi rëndësinë e
ujitjes

të rrijë brenda,
të tjerët të dalin —
bimët ujiten jashtë.

MBRËMJA KA EMRIN KATERINË

Mbrëmja ka emrin Katerinë,
deti është i kaltër, i kaltër
erë jodi dhe portokallesh
është mbushur qielli i Sarandës.

Nga një rrugë e lodhshme vijmë
nesër rrugën do nisim sërish
me një dorë të padukshme deti
na ter djersën, pluhurin fshin.

Dhe nuk duam të humbasim asgjë
çdo sekondë është e shtrenjtë këtu,
përmbi supet e mia derdhet
batica e flokëve të tu.

Rrjedhin vrullshëm nëpër gjakun tim
gjaku yt, dhe ky breg, dhe ky det
të mos duash gjer në dyzim të vetvetes
s'mund të jesh as njeri as poet.

A ËSHTË POEZIA «FËMIJA I VOGËL»?

Përgjigje një shoqeje

A është poezia «fëmija i vogël»
qoftë edhe më i bukuri,
qoftë edhe më i dashuri...

Shumë ndijime të bukura të jep fëmija i vogël;
gëzimin dhe bukurinë e jetës,
dashurinë të punosh e të rritesh,
lidhjen rrënjësore me tokën,
vazhdën e gjakut tënd nëpër shekuj...

Por poezia...

Poezia kërkon nga ti e nga gjithë të tjerët
shumë më tepër se klithmat e foshnjës.
Duart e poezisë s'janë
doçkat e fëmijës që lozin nëpër flokët e tua
por duar me gishta që të ngulen
gjer në thelbin e zemrës.
Ato kërkojnë gjithçka tënden —
dashurinë tënde si bijë e si grua,
dashurinë për fëmijën tënd të vogël
e për jetën tënde të madhe.

Ajo thith nga ti pa përkëdhelje,
pa butësi e pa fjalë të belbëta
jo thjesht qumështin
por gjakun.

Ajo është dashuria jote dhe e gjithë nënave
për të gjithë fëmijët e vegjël,
urrejtja jote e pafund
për gjithçka duhet urryer,
mohimi yt për gjithçka duhet mohuar
qoftë ky edhe fëmija yt i vogël.

Poezia është grushti mbi tavolinë
dhe lulja në parvaz të dritares,
pagjumësia e turnit të tretë,
jeta e madhe. . .
Dora me kallo e punëtorëve të kantiereve
dhe letra për nënën ose të dashurin.

Pjellore si fushat,
e rëndë si malet,
e fortë dhe e pagryeshme, si shpatullat e tyre.

Ç'i mbetet, pra, asaj
t'i thuash «fëmija i vogël»?

NJERIU I ZI

Njoh një dikë
të thuash ti, i flakët,
për drejtësinë tretur si qiri!
Por sa i dashuruar është ai me rrugën tonë
gjykoni vetë rreth portretit të tij...

Flokët i ngrihen vazhdimisht përpjetë
dhe në sy i ulen e i ngrihen vazhdimisht korba
për socializmin më flet dhe në kafe «Tirana»,
për socializmin vjen e më flet dhe në «Zërin e
popullit».

«Kini penë apo s'kini?!
Më thotë sy rrotulluar,
Po na shkatërrojnë shtetin dhe shëndetin!
Iksit dje i nisën nga jugu mjaltë kooperative
dhe arka me raki
nis mëngjeseve nëpër gaz-vetura Përmeti...»

Përplasua,
i them unë.
Këto të dhëna në qëndrojnë,
atyre që i bëjnë përpara fytyrës! —
Por sytë e tij në çast perëndojnë me frikë
si sytë e bushtres.

Dhe i skuqen faqet e limonta
dhe i varet gjer poshtë xhaketa:
— Të flas unë?! Ja, pra, i hodha,
tani le të buçasë gazeta!

Dhe vazhdon e rendit,
dhe vazhdon e nxin,
sikur të jetë pastrues oxhakësh
nga gjithë ngjyrat e ylberit ai
i aftë është të dallojë
katranin!

Mbaj veten dhe i them të shohi rrotull,
në s'mundet më tej,
të paktën — shtëpinë e tij
por ai, i mësuar vetëm me të zezën,
vazhdon e nxin.

Dhe unë ribindem se paskam nerva shumë të re-
gjura,
damarët e mi qenkan çuditërisht të fortë!
E kam dëgjuar, duruar, dëgjuar, duruar, dëgjuar
gjer te pamundësia,
gjer tek është tepër të thuash — kam kokë!

E dimë mirë —
në rrugën tonë të madhe
edhe burokratë, servilë e matrapazë
kanë dalë e mund të dalin,
por asgjë s'pësojnë ata nga rënkime e lotë burracësh
as nga psallmet.

Ata kokën e ulin,
tkurren e zhduken
(siç janë tkurrur e zhdukur për 35 vjet)

nga që mbi kufomën e tyre të kalbur
Partia
me grushtin e hekurt të klasës godet.

Ngriheni ju, motra e vëllezër,
ndërtoni
dhe shkallmoni çdo të keqe,
por kurrë ju as mburreni, as qani
siç jargavit ky nxirës mbi gotën e fërnetit.

U kam folur bukurive t'i afrohen dhe atij mbi buzë,
u kam thënë ditëve t'ia heqin cipën e zezë mbi sy,
e kam marrë për krahu dhe i kam treguar rrugët,
i kam folur për ndërtesat,
për lumenjtë, për bimët, për ju.

Por ai s'do. Ai s'dëgjon. Gjithçka i duket fals,
«lustër» thotë kur sheh njeriun që buzëqesh.
Besomëni: Në zotërimin e bukurive të jetës
ai si dhe për gjithçka tjetër është
krejtësisht impotent.

Dhe kur ndien se më kërcejnë damarët,
se krahët më dridhen si lavjerësa
«Natyrisht, thotë, unë kam besim te Partia,
kam besim tek e vërteta...»

Pusho!

(Tani vetëtimën e grushteve e kam vështirë ta mbaj.)
Si mund të ketë ky njeri i zi besim te Partia,
kur s'ka besim te vepra e saj?

QËNDRESA

Në këtë dimër të përbotshëm
plot ujqër, llohë dhe kallkan
na duhet, shok, që të qëndrojmë
siç qëndron lisi në tufan.

Dhe s'është kjo diçka thjesht jona
nuk është fjala për një shtet,
qëndresa jonë i duhet kohës
siç duhet fari në bregdet.

S'ka gjë se rrotull sheh kaq mjegull
dhe tym e temjan kurban
në thelb kjo s'është veç një perde,
në thelb kjo s'është veç iluzion.

Sepse mbi gjithë mjegullnajat,
mbi gjithë britmat çoroditëse,
po zien lava e vullkanit
ndërgjegje e popujve po rritet.

Dhe do shpërthejë ajo një ditë
me shembull nga qëndresa jonë
që pors i ndriçon rrugën
karvanit të revolucionit.

ANATOMIA E NJË KOMPLOTI

Ca «miq»
për ndihma menduan plot bujari,
i rrahën punët mirë e mirë e vendosën —
të ngrinin tri fabrika
në Shqipëri.

E para do të qe
një punishte litari,
simbol i lidhjes së madhe midis dy vendeve!
Me të
edhe mallrat do të ngarkoheshin,
edhe pavarësia jonë
do të shkonte në trekëmbësh.

E dyta do të qe
një punishte sapuni —
me vlera të dyfishta për të tilla raste:
me sapun
litari rrëshqet më mirë në qafën e të varurit,

pas kimit, me sapun
do të lanin duart
Pont Pilatët!

Por të gjitha këto duheshin bërë pa u ndier,
me dashuri,
buzëqeshje
ëmbëlsisht!...

Prandaj për të zhdukur çdo dyshim rreth kimit
e treta punishte sheqeri do të ish, natyrisht...

U ndërtuan të tria
por prodhim nuk dhanë.
Makineria tepër e vjetër qe...
Komploti,
tradhtia
të vjetra ishin
vetëm bojën e kishin të re!

NJERIU I MJEGULLAVE

(Shkurt 1961)

Tej malesh, fushash mbet Tirana
në Budapest avioni mbërrin.
Gjithçka nën mjegull është mbuluar
si një i gjallë nën qefin.

Nuk është ajo si çdo lloj mjegulle,
përzierje brenda shumë mban
diçka prej Trojës, diçka prej Nagit
kjo supë alla Mikojan.

I lehtësuar Andropovi
për herë të parë buzëqesh.
— I mrekullueshëm është, — thotë, —
ky qiell përmbi Budapest.

Ja, njerëzit tej që mirëseardhjen
kanë dalë sot për t'i uruar,

nga larg i ngjajnë robër lufte
me krahët ngritur, të dorëzuar.

Dhe ai lumë me vetura,
që rrjedh i marrë atje larg,
nën mjegull kthehet, bëhet predhë,
në ardh të puna, bëhet tank.

I sheh dhe qeshet Andropovi
por ç'fsheh pas dhëmbëve qeshja e tij?!
Kjo mjegull, — thotë, — më e bukur është
se dielli mbi Shqipëri. . .

Dhe nëpër mjegull mori udhën
po ndryshe s'kish si ndodhte, s'kish,
ai për mjegulla kish dalë,
njeri i mjegullave ish.

TRI GJËEGJËZA PËR TË ZBAVITUR FËMIJËT PARA SE TË FLENË

E PARA

Vërtitet nëpër ajër një njeri — ide
ka diku në emrin e tij një «Ce»
(plot helm është
por mos e ngatërroni me mizën Cece!).
Sa qe gjallë
tërë energjitë i derdhi mbi kokën
e rriste
që një ditë ajo të zëvendësonte botën.
Dhe u fry e u fry mbi gjithë tullumbacet
sa toka mbi shpinë
s'qe më në gjendje ta mbante.
Si i ka trupin,
ballin, gojën, sytë?!
Si në gjithë tabelat «Rrezik vdekje» që varin në
shtylla.

Në çorbë — idenë e tij
çdo lakër mund të provoni
por s'është safi
as Konfuci, as Bernshtejni, as Prudoni

nuk ish ungjillor —
me një lëvizje të gishtit
kokët e kundërshtarëve në pjatancë ia servirnin.
Natyrisht dhe ai, si gjithë sadistët,
kurrë s'i trazoi kapitalistët.

Për të imituar ishte kryemjeshtër:
E doje komunist?
Të paraqitej me mjekër.
E doje perandor?
Dinte të vepronte ai
sa i qanin sytë dhe perandorit Pao I.

Sa për notar — kurorën me hithra meriton
mbi oqean hodhi urat
Pekin-Uashington.

E gjeni dot kush është,
nëse s'ju ka zënë gjumi?

(Mao Ce Duni)

E DYTA

Përfytyroni:

Pekin. Një top llastiku në Pallatin e Verës
i dhjamur e me rrahtë metalikë mbërthyer
si Bud,

Bud i përkryer.

Brënda s'ka as raki, as shampanjë, as verë
por po t'i bësh klizmën
gjithë fëlliqësitë e botës do rrjedhin.

Mac nuk është

e megjithatë shtatë shpirtra ka,

që të shtata djallit

(d.m.th. kapitalit) ia dha.

Hidhe për tokë, fute nën dhe,

hop, kërcen

e në majë të piramidës e ke.

Pamja e tij?

Ai s'ka një fytyrë,

përditë e ndërron sipas konjunkturës.
Qafa iu zhduk,
iu bë dyst me trupin
së ushtruarit pareshtur zanatin e hajdutit.
Në vend të syve
ndez dy fenerë jeshilë
për t'u hapur udhë derri-dosës në Kinë.
Si mësues është krejt i përkryer,
të jep mësim
duke të ushqyer.

Flet ai për ngjyrën e kuqe
veç kur gjak njerëzish
pi me grushte.

Boll ju tregova,
tani është radha juaj:
emrin këtij përbindëshi vallë ia dini?

(Ten Hsiao P'in)

E TRETA

Ishte se ç'ishte, nuk ishte kurrgjë,
tani në botë flitet shumë për të,
nuk është Mao Ce Duni
e megjithatë i ngjan
siç ngjan çanaku me një sahan.
Koka e tij?
Origjinali s'i pëlqen
ndaj e mbulon vazhdimisht si struc;
ka qejf të dali në publik
si Budë, si Mao ose si Konfuc.
Dy gungat e ballit
dhe qimet përperjetë
shenja të kacafytjeve të brendshme për pushtet.
Dhëmbët i mban vazhdimisht jashtë
që lëmoshat dhe huatë
si qentë
në fluturim e sipër t'i kapë.
Betohet se socializmit besnik i qëndron
(vetëm kur vret

e kur komploton.)
Nuk është fare gdhë. Merr vesh dhe nga arti,
mjeshtër për kurthe
e puçe pallati.

Pas gjithë këtyre
kush është
a mund ta gjeni?

(Hua Kuo Feni)

Shënim:

*Emrat në fund janë vënë me kokë poshtë
Jo thjesht se Kinën këta e bënë lesharapi
Tradita e do që për gjëagjëzat
Përgjigjet të jepen së prapi.*

BASHKË

poemë

Dëshmorëve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare që dhanë jetën duke luftuar kundër fashizmit në Kosovë si dhe në Mal të Zi e në vise të tjera të Jugosllavisë.

1.

Nuk është mermer ky,
është dhembja jonë e kthyer në gur të fortë
sipërfaqen ia lëmuam vit pas viti atij
gishtat e dridhshëm të nënave dhe motrave
Dhe mbeti i bardhë. I bardhë, i bardhë
si ëndrrat.
Mes për mes gjaku juaj
përskuqur ia ka rrëmbat.

Malli na ka marrë
Mirë se erdhët!

2.

Mbi supet tona tashmë gjëmojnë vitet e luftës,
traktet e para. Thirrja. Maliherët, ja!
«Ngreu në këmbë, katundar e punëtor,
në këmbë ngreu, popull fukara!»

Dhe u ngritët ju të gjithë
s'ishit djem, por ishit drera,
drera s'qetë
por ishit lisa.
S'qetë vajza, por sorkadhe
gjithë të bukur si petrira
dhe i thatë vdekjes — Gati!
Jo tek shtrati
— tek furtunat!

Por ne nuk qajmë...

Nuk qamë as kur na erdhi lajmi
kafshatën kur në mes e premë
si fjalët tuaja në ballë të sulmit
nga plumbi mes për mes të prera.

3.

Thodhoriu ishte sa ti, djalosh.
Ai dinte të bënte bucela të bukura,
me to vajzat në jug mbushin ujë në krua,
ai dinte të bënte kade të forta,
në to verën mund ta ruanin gjer në ditët e sotme.
Sidomos për atë ditë të nëntorit 44
Shqipërisë i duheshin shumë kade.
Të nxirrnim ato ditë
nga çdo derë, dritare, rrugë e ngrehinë
verë të kuqe
— Bromp! — t'ia bënim, —
Gëzuar lirinë!

Por ai iku.
Me një breshëri drejt qiejve
përshëndeti
mbrëmjet e nesërme të fishekzjarreve,
që nga Libohova
gjer në Mal të Zi
gjaku i tij tokën e lagu.

Ikën dhe Aliu dhe Ferhati,
s'ishte akoma koha të krasisnin hardhitë.
ikën.
— Gjer në Berlin
mbi nazistët!

4

O ç'kishit dëshirë, krahët ç'ju hanin
të ndërtonit shtëpinë,
të rrisnit lirinë,
të ngisnit qetë në arë, «jepi Balash... yy!»
Ishte dhjetor,
dimri i fundit
borën e fundit lëshonte mbi ju.

Mbi pllanga gjaku ecnit
gërmadhave akoma dilte tym i zi
ndonëse pa strehë e pa dritë ishim
— Përpara, bij!
U the ti Parti.
Dhe s'kishim vetë asnjë dorë miell
një dorë miell për bukën e fitores.

Kujt t'i kërkoje ndihmë në ato ditë flake —
yjeve
apo maleve me borë?!

Ishin vite të rënda
globi i tërë ishte në zjarrm...
Sa shumë gjëra, Atdhe, ty të munguan
veç për lirinë gjithmonë the.
Kam!

Kam dashuri të pafund, të përjetshme,
kam bij që kurrë s'ulin kokën,
kam dëshirën e madhe të shekujve:
liria bleroftë botën!

5.

Ecim.

Do t'ju ngremë në një mal të lartë,
më i lartë se Tomori dhe Korabi,
do t'ju shtrijmë në një fushë të gjerë,
më e gjërë se Myzeqeja dhe Zadrima,
do t'ju bëjmë banorë të një qyteti të madh,
më i madh se Tirana dhe Vlora,
do të shkojmë drejt një kohe të ndritshme,
më e ndritshme se koha e luftës dhe e punës.

6.

Mbartim mbi supe arkivolet tuaja.
Ishte një kohë kur në erë qenë hedhura urat

e ne na duhej të bënim gjithçka.
medoemos të lidhnim brigjet.

Matanë qytetet e uritura prisnin bukën e gojës,
gurë e qereste prisnin gërmadhat
automjete-rrugët
fëmijë-shkollat,
nënat prisnin t'u ktheheshin djemtë nga lufta
toka priste farën dhe plugun,
medoemos na duheshin urat.

Por çimento s'kishim,
s'kishim as hekuri
e megjithatë brigjet duheshin lidhur patjetër.

Vumë supet tona
e mbi to kaluan të gjitha,
kaloi buka, kaloi hekuri
librat, impiantet, uzinat dhe drita.

Shqipërinë vumë mbi supet tona,
mbi supet më të forta se çdo këmbë ure,
dhe gjak u bëmë
por «oh» nuk nxorëm
nga pesha kolosale e tyre.

Nuk u përkulëm dhe s'do të përkulemi
sikur mbi supe
të mbartim edhe malet
por ç'është sot kjo peshë kaq e rëndë.
pse pas çdo hapi
ecja jonë ndalet?!

Mbartim mbi supe arkivolet tuaja,
qënien tuaj të pavdekshme si materia mbartim,
mbartim plagët që morët,
gjakun që derdhët
që nga Konispoli
gjer te Vishegradi.

Mbartim gjithçka deshët. Kujtimet tuaja,
dashuritë tuaja
mbartim atë çast kur u ndatë prej nënës,
mbi gjoksin tuaj trupi i saj.
«Lamtumirë, o mori nënë,
do të shkoj unë partizan».

Mbartim çastet e rënies. Fjalët e fundit
të rënda e me peshë malesh.
Po binit. Iknit përgjithmonë
e megjithatë s'mund të ndaheshit.

Me pikat e fundit të gjakut
dhe lëvizjet e fundit të dorës
fjalën «Liri» gdhendnit mbi tokë.
Të mund ta ngrinit krahun gjer në kupë të qiellit!

Ani!

Me katër plumbat e fundit
ngritët lart katër shkronjat e emrit të saj prej flake,
me katër pikat e fundit të gjakut
mbollët thellë
katër shkronjat e emrit të saj
si katër farë të një peme me gjelbërim të përjetshëm.

Kurmin tuaj mbi supe mbartim,
veprën tuaj të madhe.
Kjo ditë dhjetori
një borë të re thinjash
hodhi mbi kryet e bashkëluftëtarëve.

— Po qysh më je,
a e mban mënd
se si më mbarte në Skrapar?!
Plagosur kokë e këmbë isha,
vëlla, që sot mbi sup të mbart...

Ecim.

Mbi supe kemi jetën tuaj
dhe jetën tonë mbi supe kemi,
e mbollëm atë në zemrat e djemve dhe vajzave
do ta mbjellim në zemrat e nipërve dhe mbesave,
do ta mbjellim emrin tuaj brez pas brezi
të domosdoshëm
si gruri
që vit pas viti mbjellim.

7.

U rritën sot fëmijët tanë edhe tridhjetë vjet më
shumë;
nuk është heshtje kjo.

Kështu luftuat edhe ju. Të rrethuar. Nga të gjitha
anët. Dimër.

Dhe shumë i egër ish armiku. I veshur i gjithi me
hekur e vdekje.

As patate s'kishit të hanit. Asgjë
përveç zemrës dhe dyfekëve.

Por ishte dashuria juaj për këtë tokë shumë më
e madhe
se gjithë dëshirat e armiqve për të sunduar botën,
ishin idealet tuaja për lirinë shumë më të fuqishme
se çdo urrejtje e armiqve për popujt.

8.

Nuk është heshtje kjo,
nuk është as fishkëllima e erës së marrë të Sanxhakut
as kënga e violinës së Tefikut nuk është,
është fishkëllima e plumbave...

I binte ai violinës, sa bukur i binte,
në orkestrën simfonike
Violinist mund të ishte.
Mund të ish pedagog në Institutin e Arteve
do t'i këndonim këngët e tij
në të gjitha festivalet.
Por nuk është melodia e violinës së tij kjo
që na ngjeth trupin,
është kënga e kënduar
me harkun prej plumbi.

Grushtin lart!

Që ti të ngjiteshe me violinë në Teatrin e Operas,

mësuesi yt
gjakun e derdhi
në Fushë të Kosovës.

Nuk është heshtje kjo,
është përshtypja që krijohet nga bashkimi i goditjes
së çekanëve
që ndërtuan amanetin e tyre tridhjetë vjet me radhë,
i gjëmimit të traktorëve që çanë fushat tridhjet vjet
me radhë,
i shkronjave që mësuam dhe fjalëve
që shqiptuam tridhjetë vjet me radhë,
i sirenave që na çuan në uzina dhe alarme tridhjetë
vjet me radhë.

Nuk është heshtje kjo,
është betimi
se kështu do të ecim treqind vjet e tre mijë vjet
në gjakun tonë
gjaku i të rënëve rrjedh.

Grushtin lart!

Ti, Kiço, ngrite grushtin përpjetë për të hedhur
granatën,

grushti yt lart mbeti
dhe granata atje është në mes të grushtit,
dhe thirrja jote në ajër është
jehona e saj bubullon sot e do të bubullojë si stuhia:
— Në sulm, shokë!
Rroftë Shqipëria!

9.

Për secilin nga ju ngritëm lapidarë e monumente;
lule të freskëta dhe kurora dafinash
ju çojmë më 5 Maj gjithë të rënëve
«Lule djemtë e nënave. . .»

Por mund të ndodhte edhe ndryshe,
mund të bënim për ju mauzolej të veshur
me gjithë tullat, gurin dhe mermerin
që nxorëm gjatë tridhjetë vjetëve.
Mund t'ju kthenim ju në idhuj
dhe me emrin tuaj të trembnim gjithë ata
që do të guxonin të bënin pyetjen
«Pse? . . .»

Por ju që nga statujat do të gjenit forca të dilnit
e do të na thërrisnit
me zërin prej gjëmimi:
— Pse s'kanë abetare këta fëmijë,
pse s'kanë bukë t'u japin nënat?!

Ndaj ne bashkë me statujat
ngritëm fshatra dhe qytete.
Ato kanë shumë gjëra të përbashkëta me ju
Për shembull rrugët:
janë të gjera e të drejta rrugët e qyteteve tona
si trupi juaj,
si hapi juaj.
Ose dritaret:

ato janë të mëdha si sytë tuaj.
Sikur të harronim gjakun tuaj
do të qe njëlloj si të këpusje jazin e një mulliri —
sado grurë të kishe,
mokrat do të heshtnin;
do të qe njëlloj si të prishje diku
rrjedhën e një burimi jetëdhënës —
sado vajza të bukura me stoma të shkonin,
ujë s'do të rridhte;
do të qe njëlloj si të braktisje shtëpinë e dashur
të lindjes.

Kudo që të shkoje
do të mbeteshe një endacak i pastrehë.

10.

Nuk është i lehtë amaneti juaj.
Atë dinë ta mbajnë vetëm ata
që e kuptojnë
se përveç pulsit vetiak
rreh edhe një puls tjetër më i madh
puls i të gjithëve;
se përveç sofrës vetiake
duhet mbushur një sofër tjetër —
sofra e popullit;
se përveç syve të paharruar të mënës lindëse
janë edhe dy sy të tjerë
të cilët me çdo kusht duhen bërë të qeshin,
të cilët duhet të shohin nga duart e bijve
dhurata të tilla

si uzina, toka, pemë, rrugë, libra. . .

Janë sytë e Atdheut.

Tepër i rëndë është amaneti juaj,
amanet i denjë

për ata që dinë të çmojnë si gjakun dhe djersën,
për ata që përjetësinë që të jep çasti i një beteje
dinë ta ndërtojnë me unitetin e gjithë minutave
të jetës.

Amanet i denjë

vetëm për ata që s'dinë të harrojnë.

11.

Një copë predhë në rrëzë të veshit më ka mbetur
nga lufta,

dikur prej saj

rridhte gjak edhe dhimbje

mjekët nga trupi

gjithë copërat e granatave dhe plumbave na i hoqën,
Shqipëria,

si motra Gjergj Elez Alisë, na i teri plagët.

Por veç atë copë predhë nga rrëza e veshit nuk
e hoqa,

atë e ruaj

për të gjithë agresorët e kohëve

këtu e ruaj:

vëth në rrëzë të veshit,

plumb në rrëzë të veshit.

Ju e latë çekanin e vogël

dhe kopshtin e vogël,

tufën e vogël të bagëtive
dhe rrugicën e vogël që të çon gjer te shtëpia e
fqinjtit.

I latë të gjitha këto
për të çarë rrugën e madhe,
rrugën
ku do të ecnim ne me emrin tuaj në kapakët e
fletoreve,
me emrin tuaj mbi portën e kombinatit ku hyjmë
mëngjes e mbasdite,
në hyrjen e sallës ku shohim një koncert a shfaqje.

Në portat e hapura të së ardhmes
janë ndezur shkronjat e kuqe të emrit tuaj
në vend të fjalës
«Mirë se erdhët!».

12.

Është në Tiranë një shëtitore me emrin
«Dëshmorët e kombit»
mbi të tani ecim krah jush,
dëshmorë të kombit,
ecim. Bashkë.

Ju kemi mbjellë në të gjitha zemrat
siç mbjellim në tokë grurin. —
Juve të pavdekshmit
farë të sulmit.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Njerëzit për të cilët rroj	3
Krenari	5
Atdheu	7
Kërkim	9
Biografi për Tomkë Laçkën	11
Djemt e uzinës	13
Ushtar	14
Parisi	15
Nuk na lejohet të lodhemi	19
Pas shfaqjes së një premiere	21
Jehona	22
Radha	24
Militanti	25 ✕
Floriri i heshtjes	28
Porosi artistëve që vijnë	30
Këtë të thjeshtë gjë mëso	31

	Faqe
Guri i lotëve	32
Qetësia ime	34
Fillim i mësimit	35
Malet ushtarë	38
Fillimi	39
Përgjigje	40
Ishulli i qenve	41
Mbrëmje në Tiranë	42
Rrënjët	43
Ti	44
Ditë mbjelljesh	45
Loni Dhamua	46
<u>Ngrohtësi</u>	48 ✕
Sinorët	49
Guri i rrumbullakët	50
Statujat	52
Jorgua	53
Fund qershori	54
Gjiu i Vlorës më kujtohet tani	55
<u>Cabo Korvuero</u>	56 ✕
Tek kjo portë është dashuria	59 ✕

	Faqe
Botë e vogël, m'u largo!	60 XX
Nata e dashurisë	61
Pritje	62
Ti më shkruan... ..	63
«Harmonia»	65 XX
Zgjuhuni	67
Amerika	68
Lartësjtë	69
Sëmundja e butë	70
Kjo ndodhi në gusht	72
Mbrëmja ka emrin Katerinë	73
A është poezia «Fëmija i vogël»	74
Njeriu i zi	76 XX
Qëndresa	79
Anatomia e një komploti	80
Njeriu i mjegullave	82 X
Tri gjëgjëza për të zbavitur fëmijët para se të flenë	84
E para/	84
E dyta/	86
E treta/	88
Bashkë (poemë)	90